



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Puke, 10 . 10.2025

Nr. 1781 prot.

Procesverbal i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 10. 10 .2025 :
Te njoftuar per mbledhje :

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjeggaj
6. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Hazbi Terbuni

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Tetor 2025

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, i cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.09.2025
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Gusht** 2025.
3. Projekt- vendim : Për rishqyrtimin e VKB nr.28 date 04.09.2025 "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor” pas mosmiratimit nga Prefekti i Qarkut Shkodër.
4. Projekt-Vendim : "Për një ndryshim në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027(i ndryshuar)"

5. Projekt-vendim: " Për miratimin e anekseve të monitorimit të buxhetit , 4-mujori i dytë i vitit 2025"
6. Projekt-vendim : " Per dhenien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Beqir Arifaj (pas vdekjes)
7. Projekt-vendim : " Per dhenien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Fahri Bukuroshi (pas vdekjes)
8. Projekt-vendim : " Për emërtim sheshe në territorin e Bashkisë Pukë" , një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 " Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë"
9. Projekt-vendim : " Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Pukë" , një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 " Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë"
10. Projekt-vendim : " Për vendosje obelisku dhe pllakë "
11. Projekt-vendim " Për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes 0.5 ha për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, në ekonominë pyjore Krrab-Bushat , parcelat nr. 48, 49 , në pronësi të Bashkisë Pukë, Subjetit " Kola" sh.p.k
12. Projekt-vendim : Për dhënien e miratimit dhe vazhdimin e procedurës së heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.9920 ha dhe pakësimin në volum të sipërfaqeve që do të përdoren për ndërtimin e objektit agroturizëm nga zhvilluesi Xhauri Resort& Spa në ekonominë pyjore Gomsiqe në pronësi të Bashkisë Pukë.
13. Të tjera.

Ne perfundim te mbledhjes kryesia , pas diskutimit te anetareve vendosi te miratoje te gjitha pikat e projekt-rendit te dites, dhe mori Vendimin nr.6 date 10 . 10 .2025, ku u percaktua data dhe ora e zhvillimit te mbledhjes se keshillit, detyrat per sekretarin e keshillit per berjen publike te njoftimit dhe dergimin e materialeve te pergatitura per mbledhjen e keshillit , sipas rendit te dites se miratuar. Po keshtu u

percaktua dhe data dhe ora e mbledhjes se komisioneve te perhereshme te keshillit, sipas shenimit ne fund te procesverbalit.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 16.10.2025, nga ora 14³⁰ deri ne oren 16⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Kryetari I keshillit
Gjon Gjoka





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA**

Nr. 1781/1 prot.

Puke, me 10. 10 .2025

VENDIM

Nr. 6 datë 10 .10 .2025

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 30/06/2020, neni 57, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 10 .10 .2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet më datë 17. 10 . 2025, ora 13³⁰.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit të rendit të ditës, si dhe dosjen me materialet e mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Gjon Gjoka

